



FOTO: PANAIRI I PROJEKTEVE – DITA E BASHKËPUNIMIT EVROPIAN - SHKODER

# PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

IPA Programeve të Bashkëpunimit  
ndërkufitar Mal i Zi - Shqipëri dhe  
Mal i Zi - Kosovë 2014- 2020

## Dhjetor 2022

PËRMBAJTJA

Edicioni i pesëmbëdhjetë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë\* 2014-2020. Programet dhe aktivitetet e projektit financohen nga Bashkimi Evropian.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

### Programi IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socioekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

### Programi IPA BNK Mal i Zi- Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

»»» Festohet Dita e Bashkëpunimit Evropian 2022 në Shkodër.....	2
»»» Të reja nga projektet në Thirrjen e II-të të Programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri .....	3
»»» Të reja nga projektet në Thirrjen e II-të të Programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë.....	6
»»» Organizohen Forume për përfituesit e projekteve.....	9
»»» Organizohen trajnime për stafin e strukturave të programit.....	10
»»» U mbajt takimi bilateral në Tiranë.....	11
»»» Puntori ndërkufitare për gazetarë.....	11

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 dhe nuk paraqet domodoshmerisht mendimet e Bashkimit Evropian.

Башкимит Европийн  
бэлдэг долоодогдмэлэлэлтэ мэлүлүмэлтэ е

\*Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Ky projekt është i financuar  
nga Bashkimi Evropian



**MNE – ALB**  
IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI – SHQIPËRI 2014-2020



**MNE – KOS**  
IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI – KOSOVË 2014-2020

# CBC ZOOM

## Festohet Dita e Bashkëpunimit Evropian 2022 në Shkodër

Me rastin e festimit të Ditës së Bashkëpunimit Evropian 2022, Agjencia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Asistencës (SASPAC), në bashkëpunim me Ministrinë e Çështjeve Evropiane të Malit të Zi, si dhe në bashkëpunim me Bashkinë e Shkodrës dhe me mbështetjen teknike të Sekretariatit të Përbashkët Teknik (SPT), u organizua në Shkodër në datën 4 nëntor të vitit 2022 një aktivitet promovues me qëllim promovimin e projekteve të zbatuara në kuadër të Programit IPA CBC Mali i Zi – Shqipëri.

Në aktivitet morën pjesë Koordinatori Kombëtar i IPA-s në Shqipëri, përfaqësuesit e strukturave operuese të Shqipërisë dhe Malit të Zi, Kryetari i Bashkisë së Shkodrës, Prefekti i Shkodrës, Këshilli i Qarkut Shkodër, Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, SPT-ja, përfituesit e projektit, përfituesit përfundimtarë dhe publiku i gjerë, të cilët kishin mundësinë për të vizituar rezultatet e projekteve dhe për të vëzhguar qëndrueshmërinë e projekteve përkatëse të prezantuara në panair, si edhe paten rastin të vizitojnë Njësine Speciale të Ndërhyrjes së Shpejtë të mbështetur përmes projektit *Fatkeqësitë natyrore nuk njohin kufij* dhe "pitching event" të projektit *Work4Youth*.



Aktiviteti ishte gjithashtu një mundësi për të diskutuar mbi rezultatet që Shqipëria ka arritur nëpërmjet programeve të bashkëpunimit ndërkufitar dhe transnacional. Në fjalën e tij, kryetari i Bashkisë së Shkodrës z. **Bardh Spahiu** theksoi rëndësinë e programit të BE-së, i cili duke ofruar mbështetje financiare dhe teknike në fushën e zhvillimit ekonomik, përfshirjes sociale, mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë natyrore dhe historike dhe promovimit të turizmit, ka rritur bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet popullsisë së shteteve fqinje.

Koordinatori Kombëtar i IPA-s, z. **Ilir Beqaj** gjatë fjalimit të tij theksoi rëndësinë e programeve të tilla për të dyja vendet që synojnë të bëhen anëtare të BE-së. Ai shtoi se ky aktivitet është i rëndësishëm, posaçërisht duke pas parasysh faktin që nga korriku 2022 Shqipëria ka nisur procesin e negociatave për integrimin në BE. Ai ftoi të gjithë aplikantët potencial që të përdorin njohuritë nga përvoja e mëparshme dhe të përgatisin projekte më të mira dhe të thithin më shumë fonde në kuadër të IPA III.

Znj. **Nada Pejoviq**, nga Ministria e Çështjeve Evropiane të Malit të Zi theksoi se tani, në kuadër të IPA II financohen 15 projekte me vlerë totale



mbi 5 milionë euro në fushën e punësimit, mobilitetit të punës dhe përfshirjes sociale dhe kulturore, mbrojtjes së mjedisit dhe turizmin.

Ajo falënderoi përfituesit e projekteve për gatishmërinë e tyre për të përfituar nga mundësia që ofron Bashkimi Evropian përmes këtij Programi dhe për punën e mirë që po bëjnë dhe që do të bëjnë në të ardhmen.



Gjatë panairit të projekteve, në stendat e panairit u prezantuan 13 nga 15 projektet e kontraktuara dhe të gjithë pjesëmarrësit patën mundësinë të shohin secilin prej rezultateve të projektit dhe u njoftuan shkurtimisht nga përfaqësuesit e projektit mbi aktivitetet dhe rezultatet e arritura.



Gjatë vizitës në terren të projektit *Fatkeqësitë natyrore nuk njohin kufij* pjesëmarrësit patën mundësinë të takojnë *Forcat e njësisë speciale të ndërhyrjes së shpejtë në rast fatkeqësish*. Shefi i komandës prezantoi rezultatet e projektit, pajisjet e blera si 2 skafe për distanca të gjata dhe të shkurtra, motorë, makinë të re për institucionin e Prefekturës, jelekë etj.



Ai gjithashtu informoi pjesëmarrësit mbi trajnimet e ofruara nga projekti dhe dha shembuj për disa raste kur ekipi kishte për detyrë të përdorte të gjitha njohuritë dhe pajisjet për ndërhyrje për të ofruar mbështetje për njerëzit në nevojë, si për fatkeqësitë kombëtare ashtu edhe ato ndërkombëtare.



Pas kësaj, pjesëmarrësit patën mundësinë të vizitojnë një aktivitet të vazhdueshëm "Pitching Event" në kuadër të projektit *Work4Youth*. Në këtë eveniment janë prezantuar ide të reja biznesi, të përgatitura nën mentorimin e ekspertëve të projektit, nga të cilat në fund u përzgjedhën 3 ide për t'u mbështetur financiarisht. Këtë aktivitet e përshëndeti Ministrija e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrësve, znj. **Edona Bilali**, e cila theksoi se do të hapen programe dhe nisma të ndryshme qeveritare lidhur me mbështetjen e sipërmarrjes dhe punësimit të të rinjve, duke ftuar sipërmarrësit e rinj të aplikojnë në këto mekanizma mbështetës.



## Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

### 40.000 bimë mjekësore dhe aromatike të mbjellura në Plavë

Gjatë tetorit të vitit 2022, në Plavë u mbollën 40,000 bimë mjekësore dhe aromatike me qëllim rehabilitimin e zonave të degraduara. Zona e mbjellë do të përdoret si pjesë e fushatave aktuale dhe të ardhshme edukative.



Në kuadër të të njëjtit projekt është prodhuar dhe promovuar video promovuese „Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të bimëve mjekësore dhe aromatike për përmirësimin e jetesës dhe ruajtjen e biodiversitetit“ dhe mund të shihet [këtu](#).



### Aktivitetet lidhur me përmirësimin e sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit

Me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të projektit *Fatkeqësitë nuk njohin kufij 2*, u mbajt një konferencë dyditore në Budva (Mal i Zi) gjatë 30 nëntorit dhe 1 dhjetorit të vitit 2022, me temën *Përmirësimi i sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit*.



Konferenca u organizua me qëllim të ofrimit të rekomandimeve, shkëmbimit të përvojave, mendimeve, modeleve të praktikave të mira

dhe mësimëve të nxjerra në lidhje me përmirësimin e sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit, si dhe për të informuar popullatën dhe grupet e veçanta të synuara për këtë fushë. Konferenca mbledhi së bashku përfaqësues të institucioneve dhe shërbimeve që merren me mbrojtjen dhe shpëtimin, OSHC-të, partnerët e projektit dhe palë tjera të interesuara nga Mali i Zi dhe nga jashtë, të cilët prezantuan përvoja dhe raste studimore lidhur me organizimin e sistemeve të mbrojtjes dhe shpëtimit në Mal të Zi, vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian, si dhe rekomandime për përmirësimin e situatës.



Për më tepër, si pjesë e aktiviteteve të projektit, pajisjet meteorologjike me vlerë 38,000 euro dedikuar për Institutin e Hidrometeorologjisë dhe Sizmologjisë të Malit të Zi u prezantuan më 28 nëntor të vitit 2022 në Podgoricë, të cilat përfshijnë një stacion meteorologjik, një server dhe kompjuterë për parashikimin numerik të motit dhe paralajmërimin e hershëm numerik.

### **Aktivitetet e projektit SOLUTION**

Më 25 nëntor të vitit 2022 partnerët Qendra për Kërkime Ekotoksikologjike e Malit të Zi, Universiteti i Tiranës dhe Asocacioni Green Centre nga Shqipëria si pjesë e aktiviteteve të projektit *Liçeni i Shkodrës pa ndotje kimike – SOLUTION* organizuan një prezantim të rezultateve të analizës së cilësisë së ujit të liçenit të Shkodrës. Pas vlerësimit të të dhënave të marra, u konstatua se rezultatet në lidhje me ngarkesën e ekosistemit të Shkodrës me kimikate janë të kënaqshme.



Gjegjësisht, rezultatet e analizës së përmbajtjes së hidrokarbureve poliaromatike në sediment treguan një shkallë të caktuar të efektit negativ, por shkalla e kësaj barre duhet të jetë objekt i hulumtimit të mëtejshëm. Për më tepër, edhe pse është vërejtur një përmbajtje e caktuar e merkurit, PCB-ve dhe pesticideve klororganike, është theksuar se kjo është dukshëm më e ulët se përqendrimet maksimale të lejuara, kështu që mund të thuhet me siguri se krapi dhe ngjalla janë të sigurta për konsum.

Për më tepër, ekspertë të hidrogjeologjisë shpjeguan se shpërndarja e kimikateve në liçen është shumë më e madhe nga drejtimi i Malit të Zi drejt Shqipërisë, sesa anasjelltas. Gjatë prezantimit u konstatua se prania e disa ndotësve është përcaktuar dhe duhet monitoruar më tej. Shkalla e shqetësimit të mundshëm do të përcaktohet deri në fund të projektit kur të gjitha rezultatet të rishikohen dhe përpunohen.



Pas prezantimit të rezultateve partnerët zhvilluan trajnimin e tretë në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ku stafi i grupit të Kimisë Organike nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, u trajnua nga ekspertët e Qendrës së Kërkimeve Ekotoksikologjike nga Podgorica, z. **Vladimir Zhirkoviç** dhe znj. **Anja Babiç**.

Temat e programit të trajnimit ishin teknikat GC-MS, zhvillimi i metodave analitike në instrumentin e ri GC-MS të blerë nga projekti **SOLUTION** për Universitetin e Tiranës dhe kalibrimi për një sërë ndotësish organikë si PCB, pesticide, vajra minerale, PAH. etj.

### Aksion pastrimi në Guci

Si pjesë e aktiviteteve në kuadër të projektit **Mali i Zi dhe Shqipëria drejt zero mbetjeve** gjatë shtatorit të vitit 2022 qytetarët dhe autoritetet lokale me mbështetjen e fondeve të BE-së punuan së bashku drejt një rajoni më të pastër.



Përkatesisht, gjatë aksionit trefitor të pastrimit në zonat përreth Gucisë u grumbulluan më shumë se 1300 kg mbeturina. Qytetarë, nxënës të shkollave të mesme, përfaqësues të Komunës së Gucisë, Ndërmarrjes Komunale të Gucisë dhe Organizatës Turistike iu bashkuan aksionit dhe kontribuan për një mjedis më të pastër.



Si rezultat, projekti pritet të sigurojë kushte për asgjësimin, përpunimin dhe riciklimin selektiv të mbetjeve.

### Ka përfunduar projekti Work4Youth

Më 13 dhjetor të vitit 2022 u mbajt konferenca përfundimtare e projektit **Work4Youth**. Konferenca mbledhi përfaqësues të pushtetit vendor, OSHC-ve dhe të rinjve. Partnerët e projektit shfrytëzuan këtë mundësi për të paraqitur në detaje rezultatet e projektit. Arritja më e vlefshme ishte fakti se pas dy vitesh të punës intensive dhe mbështetjes, 32 të rinj me frymë sipërmarrëse nga qarku i Shkodrës, komunat e Tivarit, Tuzit



dhe Podgoricës janë gati të dalin në treg dhe të kontribuojnë me idetë e tyre të biznesit në punësim dhe zhvillimin e komunitetit lokal.

Shikoni disa nga ndërmarrjet rinore të mbështetura [këtu](#).

Projekti **Work4Youth** u zbatua nga Partnerët Shqipëtarë për Zhvillim dhe Ndryshim, Asocioni për Demokraci dhe Prosperitet – Zid dhe Intelektualët e Rinj – Shpresë.

### Fushata promovuese „Mundem dhe do t'ia dal!“ vazhdoi

Aktivitetet promovuese vazhduan si pjesë e projektit **A.C.C.E.N.T.** në të dy vendet. Partnerët e projektit promovuan histori të suksesshme punësimi në të dy vendet dhe punuan në ndërgjegjësimin përmes promovimit të shembujve të praktikave të mira në lidhje me punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Shihni historinë e suksesit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe bisedën me drejtorin e kompanisë "Centro Biro" [këtu](#).



Komunikimi i gjerë me qytetarët dhe promovimi i rezultateve të projektit në media u bë në Shkodër, ku partnerët e projektit ishin mysafirë disa herë. Shikoni një nga intervistat [këtu](#).



Gjithashtu, gjatë muajit tetor të vitit 2022, projekti organizoi ceremoninë e përfundimit me sukses të trajnimit katërditor për kërkimin aktiv të punës ku morën certifikimin 16 të rinj dhe të reja nga Shkodra dhe Lezha.



Projekti A.C.C.E.N.T.- Aksesi, Ndërgjegjia Qytetare, Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, si një Trend i ri zbatohet nga Caritas i Kryepeshkopatës së Tivarit (Mal i Zi), Caritas Shqipëri, OJF Projekti Shpresë (Shqipëri) i Asociacionit i Paraplegjikëve Tivar.

### Projekti Rrugët drejt zhvillimit të karrierës përfundoi

Më 21 dhjetor të vitit 2022, në Shkodër (Shqipëri), partnerët e projektit të projektit *Rrugët e Zhvillimit të Karrierës* organizuan konferencën finale. Aktiviteti final mbledhi përfitues të rinj nga Mali i Zi dhe Shqipëria, si dhe përfaqësues nga shkollat, organizatat dhe institucionet që mundësuan zbatimin me sukses të projektit.



Gjatë aktivitetit u prezantuan histori suksesi të të rinjve që tashmë kanë filluar sipërmarrjet e tyre, ndërsa të pranishmit diskutuan edhe për mundësitë e bashkëpunimit për mbështetjen dhe fuqizimin e mëtejshëm të të rinjve.



Rezultatet kryesore të projektit ishin aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve që përgatitën 130 të rinj nga rajonet ndërkufitare të Shkodrës dhe Ulqinit për të qenë konkurent në tregun lokal dhe rajonal të punës. Për më tepër, përmes aktiviteteve të projektit 100 të rinj kanë eksploruar projekte/ide të reja biznesi që përputhen me kërkesat e tregut të punës, janë organizuar 50 praktika në bizneset lokale, ndërsa janë financuar 13 projekt-ide më të mira për të filluar biznesin e tyre të vogël.

Shikoni videon me rezultatet e projektit [këtu](#).

### Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

#### Të ardhurat e para direkte nga bujqësia për përfituesit

Në kuadër të projektit *Krijimi i punësimit në bujqësi*, përfituesit në Kosovë që kanë kultivuar bimë mjekësore gjatë viteve 2021-2022 kanë fituar të ardhurat e tyre direkte nga bujqësia. Gjegjesisht, këto produkte u shiten pikave grumbulluese dhe kompanive eksportuese me të cilat kanë nënshkruar kontrata 5 vjeçare si një nga rezultatet e projektit.

Për më tepër, praktikantët që kaluan punë praktike në kompani të ndryshme për të rritur kompetencat dhe njohuritë e vlerësuan si të suksesshëm programin e praktikës. Konkretisht, nga 22 persona që kanë kaluar praktikën, 13 prej tyre janë punësuar dhe kanë gjetur mundësi punësimi falë skemave të praktikës.



Projekti *Krijimi i punësimit në bujqësi* zbatohet nga Kryeqyteti Podgorica dhe Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK.

#### Përfundoi projekti PRAXIS

Gjatë muajit tetor dhe nëntor të vitit 2022, janë organizuar njëmbëdhjetë sesione kolektive udhëzuese për mbi 145 të rinj të papunësuar nga komunat Berane, Petnjicë, Plavë dhe Guci. Konkretisht, seancat u organizuan në Beranë në Zyrën e Punësimit, Gjymnazin "Panto Malishiq"

dhe shkollën fillore "Vuk Karaxhiq", si dhe në shkollën fillore "Xhafer Nikoçeviq" në Guci dhe shkollën fillore në Trpezi dhe "25 Maj" në Petnjicë. Gjithashtu, katër punëtoritë e orientimit në karrierë u organizuan në shkollën e Mjekësisë në Berane, me theksin kryesor në kërkesën e tregut në sektorin e mjekësisë dhe më shumë se 50 pjesëmarrës morën pjesë në këto evenimente për ngritjen e kapaciteteve. Përveç kësaj, u organizuan trajnime të Orientimit të Karrierës për trajnerë për pjesëmarrësit nga Berana, Gucia dhe Petnjica. Gjatë nëntorit të vitit 2022, u organizuan 5 sesione "Soft skills II - Trajnime kreative" si trajnim pesëditor ku morën pjesë më shumë se 120 nxënës dhe të rinj të papunësuar. Trajnimet pesëditore që synonin lehtësimin e punësimit të të rinjve, ishin të fokusuar në tema të tilla si puna ekipore, fleksibiliteti, zgjidhja e problemeve, menaxhimi i kohës, aftësitë komunikuese dhe prezantuese, aftësitë krijuese, inteligjenca emocionale dhe aftësitë ndërpersonale, etika e biznesit.



Më 16 dhjetor të vitit 2022, stafi profesional i shkollave të larta profesionale dhe mjekësore nga komuna e Beranes, pati mundësinë të shkëmbejë praktika të mira dhe të krijojnë bashkëpunim duke vizituar stafin drejtues dhe profesional të Qendrës për Edukim dhe Këshillim Profesional "Gjon Nikollë Kazazi", të shkollës së mesme teknike "Nexhmedin Nixha", shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" dhe të ndërmarrjes private "Veer" Studio Design në Gjakovë.



Për më tepër, gjatë nëntorit dhe dhjetorit të 2022, u organizuan disa vizita për gjetjen e punës në bashkëpunim me palët e interesuara nga komunat e Beranes, Petinjës, Plavës dhe Gucisë. Të rinjtë (rreth 70) që vizituan kompanitë në Berane (SH.P.K. "Nikola", Qendren Rajonale të Biznesit, SH.P.K. "Green One", Hotel "Berane" dhe ndërmarrjen "Arte Casa") patën mundësinë të merrnin informacion mbi ecurinë e biznesit nga këto kompani, nevojat e kompanisë dhe kualifikimin e fuqisë punëtore të kërkuar për pozicione të ndryshme, prodhim, teknologji, etj.

Më në fund, si evenimet përmbyllës, konferenca finale u mbajt më 22 dhjetor të vitit 2022 në Berane. Konferenca mbledhi mbi 40 pjesëmarrës,

duke përfaqësuar aktorë të ndryshëm si institucionet publike nacionale dhe lokale, institucionet arsimore, OJQ-të, zyrat dhe shërbimet e punësimit, qendrat rinore, etj. Gjatë konferencës u prezantuan rezultatet kryesore të arritura dhe një video promovues, ndërsa certifikatat për orientim dhe këshillim në karrierë u janë dorëzuar përfituesve. Të pranishmit diskutuan edhe për çështjen e punësimit të të rinjve dhe patën mundësinë të këmbëjnë përvojat, njohuritë dhe idetë, si dhe të nxisin bashkëpunimin ndërmjet institucioneve. Për më shumë informacion shikoni videon promovues të projektit *PRAXIS*, duke klikuar [këtu](#).



### CARES 2 vazhdimi i aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ngritjen e kapaciteteve

Projekti CARES 2, si vazhdimësi e rezultateve të projektit të mëparshëm nga CARES 1, po zbatohet me sukses nga një partneritet afatgjatë ndërmjet FORS Malit të Zi dhe ECMI Kosova. Në kuadër të kësaj periudhe të zbatimit të projektit janë organizuar aktivitete të ndryshme ndërgjegjësuëse, si dhe ekzaminime parandaluese dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve. Gjithashtu, procesi i prokurimit të pajisjeve mjekësore është duke u finalizuar dhe pajisjet do t'u dorëzohen institucioneve shëndetësore në periudhën e ardhshme. Muaji tetor si muaji kundër kancerit të gjirit u shënu në Mal të Zi dhe Kosovë, përmes njoftimeve të ndryshme për shtyp, publikimeve në media, emisioneve televizive dhe artikujve, vendosjes së tabelave dhe shpërndarjes së materialeve informative dhe promovuese.



Gjatë kësaj periudhe janë organizuar dy trajnime ndërkufitare. Përkatesisht, në Tivar (Mal i Zi) në periudhën 26-28 tetor të vitit 2022 është organizuar trajnimi mbi parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e kancerit të gjirit për punëtorët mjekësorë nga Mali i Zi dhe Kosova. Trajnimi mbi parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e kancerit të qafës së mitrës është organizuar në Pejë (Kosovë) në periudhën 22-24 nëntor të vitit 2022 për mjekë specialiste të

gjinekologjisë, onkologjisë, patologjisë dhe mjekësisë familjare nga Kosova dhe Mali i Zi. Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte përmirësimi i njohurive dhe aftësive të pjesëmarrësve në lidhje me faktorët e rrezikut, opsionet e parandalimit, incidencën, PAP testet, mamografinë, ekzaminimet me ultratinguj, rezonancë magnetike të gjirit, trajtimin e kancerit të qafës së mitrës, etj. Gjatë këtyre trajnimeve ndërkuftare stafi mjekësor nga Mali i Zi dhe Kosova patën mundësinë të përmirësojnë bashkëpunimin e tyre ndërkufitar dhe të mundësojnë shkëmbimin e përvojave, mësimave të nxjerra dhe modeleve të praktikave të mira në parandalimin, trajtimin dhe diagnostikimin e kancerit të gjirit dhe kancerit të qafës së mitrës.



Gjithashtu, janë mbajtur dy tryeza të rumbullakëta në temën "Përmirësimi i shëndetit riprodhues dhe prezantimi i rezultateve të arritura në kuadër të projektit CARES 2", gjegjësisht një në Tivar (Mal i Zi) dhe një në Pejë (Kosovë). Qëllimi i këtyre ngjarjeve ishte që të mundësohet diskutimi mes palëve të interesuara nga Mali i Zi dhe Kosova, si dhe të shkëmbehen mendimet, qëndrimet, praktikat më të mira, sfidat dhe mësimet e nxjerra dhe të përmirësohet bashkëpunimi ndërkufitar në këtë fushë të shëndetit riprodhues. Në Kosovë, gjatë muajit shtator dhe tetor të 2022, janë organizuar 10 ligjërata për gratë për shëndetin riprodhues, të cilat janë realizuar nga mjekë – gjinekologë. Vëmendje e veçantë iu është kushtuar mbledhjes së grupeve të duhura të synuara në ligjërata – gra nga zona e synuar me theks në grupet e cenushme sociale.



Me qëllim të ofrimit të edukimit për infermieret nga zona e synuar nga Mali i Zi dhe Kosova, shkolla e e shtatzënisë është organizuar në periudhën 18-21 tetor të vitit 2022 në Tivar (Mali i Zi), si trajnim katërditor ndërkufitar. Qëllimi i trajnimit ishte përmirësimi i kapaciteteve dhe rritja e njohurive dhe kompetencave të infermiereve nga rajoni i synuar për të ofruar mbështetje adekuate për gratë shtatzëna dhe për të mbajtur kurse shtatzënie në rajonin e synuar. Gjatë trajnimit u ndanë me pjesëmarrësit tema të ndryshme, duke përfshirë shembujt dhe praktikat më të mira në lidhje me shtatzëninë.

Për më tepër, është organizuar edhe një kamp rinor për nxënësit e shkollave të mesme si trajnim treditor në Tivar (Mal i Zi) në periudhën 19-21 tetor të vitit 2022. Trajnimi u mbajt nga specialistë përmes prezantimeve të ndjeshme këshilluese të përshtatura sipas moshës dhe interesave të tyre, duke synuar t'u mundësojë pjesëmarrësve të mësojnë për stilet e shëndetshme të jetesës, sjelljen e përgjegjshme në lidhje me shëndetin e tyre, rëndësinë e parandalimit dhe ekzaminimeve të rregullta mjekësore, etj.

### Përfundoi projekti Transhumance

Ekspedita promovuese (FAM Trip) e projektit *Transhumance* – oferta e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi u organizua më 6 dhe 7 tetor të vitit 2022 me gazetarë, operatorë turistikë, pjesëmarrës ndërkombëtarë dhe palë të interesuara aktive në ofrimin e shërbimit turistik dhe zhvillimin e turizmit malorë. IADK si partner kryesor udhëhoqi udhëtimin dyditor në bjeshkët e Istogut dhe Pejës. Gjatë udhëtimit, pjesëmarrësit qëndruan një natë në një nga 56 katunet me energji diellore.



Pjesëmarrësit shijuan peizazhin mbresëlënës dhe shijet tradicionale të kuzhinës. Ekspozimi ndaj katuneve të traditës së lashtë u mundësoi pjesëmarrësve të interesuar ta përfshijnë këtë në ofertën e tyre turistike si dhe ta promovojnë sa më shumë këtë traditë.



Shtegu i vizituar u krijua në kuadër të projektit dhe vizitorët tani kanë mundësinë të kalojnë natën në të ashtuquajturat kasollat e barinjve, të hanë ushqim tradicional në nëntë pika pushimi ose të përjetojnë natyrën në pesë pushimore në vendet më të bukura të Bjeshkëve të Nemuna.

Nga ana tjetër, AZHR për Bjelasica, Komovi dhe Prokletije organizoi aktivitet të ngjashëm më 6 tetor të vitit 2022. Përkatesisht, udhëtimi promovues u organizua përgjatë shtigjeve tematike "Kullotat e Peshterit" në Mal të Zi dhe u vizituan Katunet brenda shtegut. Agjenci të ndryshme udhëtimi që tashmë kanë produkte të ngjashme në ofertën e tyre, si dhe gazetarë, shkrimtarë udhëtimesh, ekipe televizive dhe blogerë iu bashkuan AZHR-së në udhëtimin promovues. Qëllimi i këtij



aktiviteti ishte rritja e promovimit të katunëve si ofertë turistike.



### Përfundoi projekti Trashëgimia kulturore - Thesar i rajonit ndërkufitar

Në kuadër të aktiviteteve të projektit *Trashëgimia kulturore – Thesari i rajonit ndërkufitar*, në periudhën 24 – 28 tetor të vitit 2022 në Guci, u mbajt Ekspozita e Kolonisë së Artit si iniciativë e përbashkët e Pejës dhe Gucisë. Në kuadër të këtij aktiviteti, 5 artistë nga Peja dhe 5 artistë nga Gucia pikturuan 10 objekte të trashëgimisë së Gucisë me qëllim të promovimit të trashëgimisë kulturore dhe shkëmbimit të përvojave.



Pikturat e krijuara gjatë Kolonisë së Artit në Guci dhe ato të krijuara gjatë Kolonisë së Artit në Pejë u ekspozuan më 28 tetor të vitit 2022, me qëllim promovimin e aseteve të trashëgimisë kulturore të të dy vendeve.

“Udhëtimi i Familiarizimit” ndërmjet operatorëve turistikë të Pejës dhe Gucisë u organizua në periudhën 27-28 tetor të vitit 2022. “Udhëtimi i Familiarizimit” filloi në Pejë dhe vazhdoi në Guci, gjatë të cilit pjesëmarrësit patën mundësinë të vizitojnë asetet e trashëgimisë kulturore përgjatë shtegut kulturor dhe të përdorin audio-udhëzuesit si një burim informacioni në lidhje me ato asete. Gjatë periudhës së fundit të zbatimit të projektit, është blerë flip-bordi digjital në Pejë.

#### FAKTE TË SHPEJTA - Flip-board dixhital

Flip-board dixhital është një platformë interaktive e pasur me përmbajtje, lehtësisht e aksesueshme dhe ka softuerin më të avancuar që ofron veçori grafike dhe shënimesh (me mundësinë për të integruar një gamë të gjerë mediash si video, përmbajtje interaktive ose modele 3D).



Konferenca finale u mbajt më 31 tetor të vitit 2022. Gjatë konferencës u konstatua se implementimi i suksesshëm i projektit u arrit nga një bashkëpunim i fortë ndërkufitar me synim zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në të dy vendet.



Gjithashtu është theksuar se ky projekt mund të shërbejë si shembull se sa të mëdha mund të jenë rezultatet kur të gjithë janë të vendosur për të arritur të njëjtin qëllim me të njëjtin vizion dhe energji.



### Organizohen Forume për përfituesit e projekteve

Sekretariati i Përbashkët Teknik në bashkëpunim me strukturat Operuese të Programeve organizuan forumet e diskutimit me përfituesit e projektit të Thirrjes së dytë për dërgimin e projekt-propozimeve në të IPA Programeve bashkëpunimit ndërkufitarë Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi – Kosovë. Forumi për përfituesit e projektit të Thirrjes së dytë për dërgimin e projekt-propozimeve në kuadër të IPA Programite bashkëpunimit ndërkufitarë Mal i Zi – Shqipëri është organizuar me datë 9 shtator të vitit 2022 në Shkodër (Shqipëri), kurse Forumi i diskutimit me përfituesit e projektit të Thirrjes së Dytë për dërgimin e projekt-propozimeve në kuadër të IPA Programite bashkëpunimit ndërkufitarë

Mal i Zi – Kosovë është organizuar me date 16 shtator të vitit 2022 në Prishtinë (Kosovë).

Evenimetet janë mbajt me qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e ndikimit të zbatimit të projekteve përmes shkëmbimit të pikëpamjeve të përfituesve të granteve në lidhje me zbatimin e projekteve, çështjet aktuale dhe praktikrat e mira dhe nxitjen e komunikimit ndërmjet projekteve.



Këto Forume u organizuan me qëllim të rritjes së kapaciteteve të përfituesve të projekteve, gjatë së cilës u prezantuan gjetjet nga SPT-së dhe u pasua me diskutime në grup, pyetje dhe përgjigje, shembuj dhe ilustrime praktike nga puna dhe përvoja e përditshme. Për më tepër, pjesëmarrësit u nxitën të ndajnë sfidat e tyre specifike me të cilat përballen gjatë fazës së zbatimit, duke synuar të bëjnë një listë të vështirësive dhe zgjidhjeve të aplikuara nga përfitues të ndryshëm.



Forumet ishin një mundësi e mirë për t'u mundësuar përfituesve të granteve të projekteve, të cilët janë në zbatim në kuadër të Thirrjes së dytë, që të rrisin bashkëpunimin ndërmjet projekteve të ngjashme, të përmirësojnë komunikimin ndërmjet partnerëve dhe projekteve të ngjashme, dhe të identifikojnë sfidat kryesore dhe idetë e përbashkëta për të zgjedh problemet, si dhe të diskutojnë mbi praktikrat më të mira.

### Organizohen trajnimet për stafin e strukturave të programit

Gjatë shtatorit të vitit 2022, janë organizuar dy aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për stafin e strukturave operuese (Ministria e Çështjeve Evropiane të Malit të Zi, Ministria e Financave e Malit të Zi – Drejtoria për Financa dhe Kontraktimi e

Fondeve të BE-së, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës dhe Agjencia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës së Republikës së Shqipërisë) dhe Sekretariatit të Përbashkët Teknik të IPA Programeve të bashkëpunimit ndërkufitarë Mal i Zi-Shqipëri dhe Mal i Zi-Kosovë 2014-2020.

Trajnimi i parë mbi Vlerësimin e *Thirrjeve për dërgimin e projekt-propozimeve* u organizua dhe u mbajt në datat 7 dhe 8 shtator në Shkodër (Shqipëri), gjatë të cilit 19 pjesëmarrës patën mundësinë të fitojnë njohuri mbi procesin e vlerësimit. Trajnimi kishte për qëllim arritjen e një kuptimi të zgjeruar të dispozitave të Thirrjes për dërgimin e projekt-propozimeve me theks të veçantë në përzgjedhjen e koncepteve dhe aplikimeve të plota. Përveç përfaqësuesve të strukturave operuese dhe SPT-së, në trajnim morën pjesë edhe përfaqësuesit e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Mal të Zi dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri. Trajnimi u zbatua nga eksperti i CBIB+, z. **Enrique Aguado Asenjo**.



Trajnimi përfshinte aspektin teorik, praktik dhe punë në grupe. Pjesëmarrësit morën njohuri dhe informacion se si të adresojnë praktikisht problemet me të cilat ballafaqohen komitetet e vlerësimit gjatë vlerësimit të Thirrjes për dërgimin e projekt-propozimeve në hapat 1 "vlerësimi i koncepteve" dhe 2 "vlerësimi i aplikimeve të plota".

Përveç kësaj, atyre iu ofruan këshilla profesionale se si të adresojnë çështjet delikate në komunikimin me aplikantët (p.sh. sqarimet) dhe se si të



plotësojnë

tabelen e vlerësimit për konceptet dhe aplikimet e plota brenda këtyre dy Programeve. Aktiviteti i dytë për ngritjen e kapaciteteve, Trajnimi mbi Parregullsitë dhe Riskun, u organizua më 14 dhe 15 shtator në Prishtinë (Kosovë) dhe në të morën pjesë 19 pjesëmarrës. Trajnimi për parregullsitë dhe riskun u mbajt me qëllim përforcimin e kapaciteteve të strukturave operuese dhe SPT-së lidhur me parregullsitë dhe menaxhimin e riskut në lidhje me projektet e financuara nga BE në kuadër të Programeve në përputhje me rregullat, standardet dhe procedurat e BE-së. Trajnimi u mbajt nga dy ekspertë, znj. **Mirjana Juriq**, Shefe e Shërbimit AFCOS në Ministrinë e Financave të Kroacisë dhe znj. **Ana Srdiniq-Kovaçiq**, Shefe e Departamentit për Auditimin e Operacioneve në kuadër të Agjencisë për Auditim të Sistemit të Zbatimit të Programeve të Bashkimit Evropian (ARPA) të Kroacisë.



Gjatë trajnimit dyditor pjesëmarrësit patën mundësinë të fitojnë njohuri dhe të shkëmbejnë përvojë dhe të diskutojnë për menaxhimin e riskut dhe parregullsiave, instrumentet dhe metodat për zbulimin e parregullsiave, mënyrat e raportimit për parregullsitë dhe rikuperimin e dëmit të shkaktuar, dyshimin për mashtrim dhe zbulimin e tij, kryerjen e auditimit, verifikimit dhe kontrolleve. Pjesëmarrësit patën gjithashtu mundësinë të marrin informacion për të kuptuar konceptin, funksionimin dhe rolin e AFCOS (Shërbimi i koordinimit kundër mashtrimit) dhe OLAF (Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit), si dhe të dëgjojnë shembuj nga Kroacia nga periudha e procesit të aderimit dhe nga periudha që kur janë anëtarësuar në BE.

## U mbajt takimi bilateral në Tiranë

Në kuadër të aktiviteteve të rregullta të IPA Programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mal i Zi – Shqipëri, në Tiranë, më 31 tetor të vitit 2022 u zhvillua një takim bilateral ndërmjet Strukturave Operuese. Takimi u organizua me qëllim të diskutimit të aktiviteteve të vazhdueshme programore në kuadër të IPA II dhe IPA III.



## Puntori ndërkufitare për gazetarë

Sekretariati i Përbashkët Teknik organizoi një punëtorë ndërkufitare për gazetarët në kuadër të IPA Programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mal i Zi-Shqipëri me mbështetjen e Strukturave Operuese të Programit, me qëllim që të familjarizojë gazetarët nga Shqipëria dhe t'i inkurajojë ata të prodhojnë produkte mediatike mbi rezultatet e arritura dhe rrëfimet interesante nga projektet e financuara në kuadër të këtij Programi dhe, në këtë mënyrë, të informojnë qytetarët mbi projektet dhe arritjet e tyre.

Punëtorja u organizua më 11 nëntor të vitit 2022 dhe u ndoq nga media vendase dhe kombëtare shqiptare, të cilat patën mundësinë të vizitojnë projektet dhe arritjet e tyre në terren dhe të diskutojnë me aktorët e projektit dhe përfituesit përfundimtarë mbi rëndësinë e këtyre projekteve, mbi bashkëpunimin ndërkufitar dhe mbi rëndësinë e mbështetjes së BE-së për komunitetet lokale.



Punëtorja filloi me viziten në fermën e lule mjedrës së **Kol Shabenit** në Bushat, ku gazetarët patën mundësinë të vizitojnë investimin e realizuar nga projekti *Të Rinjtë Malazet dhe Shqiptarë për kulturën e Lule Mjedrës*. Pronari i fermës shpjegoi përfitimet e mbjelljes së lule mjedrës dhe mbështetjen financiare dhe teknike të ofruar nga projekti. Gjithashtu, koordinatoresha e projektit, znj. **Rozeta Gradeci** nga COSPE, nënvizoi rëndësinë e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar për ndërhyrje të tilla dhe mbështetjen e familjeve rurale. Ajo informoi gazetarët se projekti u mundësoi 21 fermave në rajon të mbjellin për herë të parë lule mjedrën dhe se tashmë bizneset, restorantet etj., janë shumë të interesuar për ta blerë këtë produkt. Fermat e mbështetura tani korrin benefite konkrete.



Pas fermës së lule mjedrës, grupi shkoi për të vizituar stacionin meteorologjik të instaluar në Uren e Bunes në kuadër të projektit *Fatkeqësitë natyrore nuk njohin kufij*. Koordinatorin e projektit, z. **Andris Tufi**, shpjegoi detajet teknike të përdorimit të stacionit meteorologjik dhe shtoi rëndësinë e një teknologjie të tillë në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit. Ai gjithashtu informoi gazetarët se në fazën

e parë dhe të dytë të këtij projekti janë instaluar 5 stacione në rajon, shumë materiale janë dorëzuar në *Njësinë e Specializuar të ndërhyrjes së shpejtë* në rast përmbytjeje, si edhe shumë pajisje dhe materiale për trajnimin e zjarrfikësve.



Pranë stacionit meteorologjik, grupi pati mundësinë të vizitonte disa nga skulpturat e përgatitura dhe instaluarat përmes projektit "*Simpoziumi i Skulpturës*" financuar në kuadër të programit Mal i Zi-Shqipëri 2007-2013. Pastaj, pas një pushimi të shkurtër, grupi udhëtoi për në fshatin Hot, në Malësi të Madhe për të vizituar lokalitetin arkeologjik të kishës së krishtere të shekullit V.



Në kantier patën mundësinë të takohen me koordinatoren e projektit **Ormri Shqarri** i cili prezantoi në detaje ndërhyrjen e parashikuar nga projekti, lokalitetet e gjurmëve, mbetjet e kishës, masat mbrojtëse dhe rezultatet e arritura si pjesë e projektit *Rritja e bashkëpunimit – Nga antikitetet Kristiane drejt përmirësimit të Turizmit*.


Pjesëmarrësit patën mundësinë të përdornin QR kodin në pllakën e njoftimit dhe të shihnin fotot virtuale të kishës së vjetër. Z. Shqarri nënvizoi se artefaktet më të vlefshme nga lokaliteti arkeologjik ndodhen në ambientet e Kishës së Hotit. Konkluzionet e nxjerra nga biseda ishin se fondet e BE-së të përdorura në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar kontribuojnë në zhvillimin e sektorit të turizmit në rajon.

Pas kësaj, të pranishmit vizituan kishën e Hotit për të parë artefaktet e zbuluara nga procesi i gjurmëve.

Pas vizitës së lokacionit në Hot, gazetarët patën mundësinë të vizitojnë pikën ndërkufitare Grabom të projektit strategjik *Rindërtimi i pikës ndërkufitare Hani Hot – Bozaj dhe ndërtimi i pikës kufitare Cemi i Trijeshit – Grabom* të kontraktuar në kuadër të IPA Programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mal i Zi-Shqipëri 2007-2013. Në pikën e kalimit kufitar grupi u takua me **Elvin Bercajn**, përfaqësues i Drejtorisë së Doganave.



Z. Bercaj dhe detaje të funksionimit të pikës kufitare dhe përshkroi rëndësinë e ofrimit të këtij shërbimi për qytetarët e zonës.



[www.cbc-mne-alb.org](http://www.cbc-mne-alb.org)  
[www.cbc-mne-kos.org](http://www.cbc-mne-kos.org)

»» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



Ministry  
of European Affairs



Montenegro  
Ministry of Finance  
Directorate for Finance and Contracting  
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
KRYEMINISTRIA  
AGJENCIA SHITËTORE E PROGRAMIT STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDËHMËS



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Çeveria - Vlada - Government  
Ministria e Pushtetit Lokal  
Ministarstvo lokalne samouprave  
Ministry of Local Government



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA  
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**  
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi  
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

**Sanja TODOROVIC**

Drejtuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik  
E-mail: [sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Maja RADOVIC**

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat  
E-mail: [maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Nikola DJONOVIC**

Zyrtar Projekti  
E-mail: [nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Almir CAUSEVIC**

Zyrtar Projekti  
E-mail: [almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Petar BELADA**

Asistent Administrativ  
E-mail: [petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org)

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**  
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri  
Telefon: + 355 22 80 20 80;

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**  
Adresa: Kompleksi PRIME, rruga "Tirana", Hyrja D, kati 5, Zyra nr. 53, Prishtinë,  
Kosovë

**Gazmir RACI**

Zyrtar Projekti, Antenë  
E-mail: [gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org)

[www.cbc-mne-alb.org](http://www.cbc-mne-alb.org) | [www.cbc-mne-kos.org](http://www.cbc-mne-kos.org)



@cbc.mne.alb



@cbc.mne.kos



Ky projekt është i financuar  
nga Bashkimi Evropian